



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 27. 04. 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Në mbledhje morën pjesë: Rita Hajzeraj – Beqaj - nënkryetare, Ismet Beqiri, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Duda Balje, Justina Shiroka-Pula dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Suzana Novoberdaliu – kryetare dhe Albana Gashi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi – OSBE, Jahir Bejta, Fahri Buqinca dhe Nafie Kuqi nga Sindikata e Pavarur e Invalidëve dhe Pensionistëve të Kosovës, Natyra Kosumi - NDI dhe Burim Tahiri, praktikant nga Kuvendi i Kosovës.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Rita Hajzeraj - Beqaj – nënkryetare e parë.

Rita Hajzeraj – Tha se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Fjala e rastit lidhur me shënimin e ditës së të pagjeturve, më 27 Prill,
4. Nxjerrja e konkluzioneve lidhur me petitionin e pensioneve të SPIPK-ës,
5. Shqyrtimi i disa kërkesave,
6. Të ndryshme.

Komisioni e miratoi propozimin e kryesueses, por nga rendi i ditës u kërkuar të hiqet pika e tretë.

Rita Hajzeraj- Beqaj, zëvendëskryetare e parë, në fillim i përshëndeti përfaqësuesit e shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore, monitoruesit, si dhe mjetet e informimit. Ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me aktivitetet që do të shënojnë ditën e sotme, 27 Prillin, Ditën e Personave të Pagjetur. Përkitazi me këtë, ajo tha se Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Komisionin Qeveritar për Persona të Pagjetur ka organizuar disa aktivitete me qëllim të sensibilizimit dhe informimit të opinionit vendor dhe ndërkombëtar për përkujtimin e viktimave dhe për përsheptimin e veprimeve të institucioneve në zbardhjen e fatit të më se 1.860 personave të pagjetur.

Në vijim, Hajzeraj –Beqaj, i njoftoi se Zyra e Kryeministrit dhe Komisioni Qeveritar, e ka ftuar Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione që të marrë pjesë në Akademinë përkujtimore, e cila do të mbahet sot në Kinemanë “ABC”, në orën 12:00 kushtuar personave të pagjetur.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 13. 04. 2011

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13. 04. 2011.

4 Nxjerrja e konkluzioneve lidhur me petitionin e pensioneve të SPIPK- së

Ajo, lidhur me konkluzionet e dala nga takimi që e zhvilloi Komisioni me përfaqësuesit SPPIK- së, i propozoi Komisionit që lidhur me këto Rekomandime të shqyrtohen në mbledhjen e radhës, pasi që do të ishte e pranishme edhe kryetarja e Komisionit, Suzan Novoberdaliu.

Komisioni u pajtua me propozimin dhe vendosi që kjo pikë të debatohet në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i disa kërkesave

Komisioni në fushëveprimtarinë e vet shqyrtoi kërkesën e Këshillit koordinues të asociacioneve të familjeve të të zhdukurve të Kosovës, me të cilën kërkohet që me rastin e miratimit të projektligjit për buxhetin e vitit 2011 të përfshihet edhe kjo kategori për personat e zhdukur, që të ketë rritje pensionale dhe benefite të tjera, si kategori shoqërore e viktimizuar.

Komisioni, pasi e shqyrtoi kërkesën e Këshillit Koordinues të Asociacioneve të familjeve të të zhdukurve të Kosovës, i rekomandon që kërkesën në fjalë t’ia dërgojnë Ministrisë përkatëse me rastin e rishikimit të buxhetit.

Komisioni gjithashtu u njoftua me kërkesën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, lidhur me kërkesat e të burgosurve të Qendrës Korrektuese të Dubravës, të cilët gjenden në vuajtje të dënimit dhe kërkohet që kjo kategori e të burgosurve t’i realizojnë të drejtat e tyre në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Komisioni e mbështet çdo nismë të mirë dhe të gjitha kërkesat të cilat janë të arsyeshme dhe të realizueshme.

Meqë kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, Komisioni ju rekomandon të burgosurve në Qendrën Korrektuese të Dubravës që t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë, meqë ka të bëjë me Ligjin për amnisti dhe këto çështje të ngritura bien në fushëveprimin e tij.

6. Të ndryshme.

Kryesuesja i informoi lidhur me Akademinë përkujtimore për nder të 27 Prillit, për persona të pagjetur dhe kërkoi nga anëtarët që të marrin pjesë në këtë akademi dhe shtoi se Komisionit i është lënë hapësirë që të paraqesë fjalë rasti lidhur me ditën e të pagjeturve. Pastaj shtoi se nisja do të bëhet në orën 11:50, ndërsa do të mbahet në Kinemanë ABC në Prishtinë!

Mbledhja përfundoi në orën 11: 00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesja e Komisionit

Rita Hajzeraj - Beqaj